



**VENDIM**  
**Nr.212, datë 11.3.2020**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË  
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN  
E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE  
ARSIMORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 3, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore (projektimin, zbatimin e punimeve, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e këtyre objekteve) në vlerën, gjithsej, 7 978 134 932 (shtatë miliard e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e njëqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë, përfshirë:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në vlerën, gjithsej, 4 347 753 223 (katër miliard e treqind e dyzet e shtatë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e tre) lekë.

b) Bashkisë Tiranë, në vlerën, gjithsej, 3 630 381 708 (tre miliard e gjashtëqind e tridhjetë milionë e treqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind e tetë) lekë.

2. Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë 1 994 533 733 (një miliard e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër milionë e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) lekë, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm” të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 1 086 938 306 (një miliard e tetëdhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtë) lekësh.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 907 595 428 (nëntëqind e shtatë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e njëzet e tetë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim”, të buxhetit të shtetit

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**